



# MANUAL TRAJNIMI

## MONITORIMI I JASHTËM

Zbatimi i Kujdesit Shëndetësor në Banesë  
nga  
Strukturat e Kujdesit Shëndetësor Parësor



Me mbështetjen e Projektit  
“Shëndet për të Gjithë - HAP”

**Korrik 2023**



# **MANUAL TRAJNIMI**

## **MONITORIMI I JASHTËM**

**Zbatimi i Kujdesit Shëndetësor në Banesë**

**nga**

**strukturat e Kujdesit Shëndetësor Parësor**

*Me mbështetjen e projektit "Shëndet për të Gjithë"- HAP*

**Korrik 2023**

## Parathënie

Ky manual trajnimi synon aftësimin e kapaciteteve monitoruese të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit shëndetësor (OSHKSH), Njësive Vendore të Kujdesit Shëndetësor (NJVKSH) dhe Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor (FSDKSH) për monitorimin mbështetës të zbatimit të Kujdesit Shëndetësor në Banesë (KSHB) nga strukturat e kujdesit shëndetësor parësor (KSHP). Manuali është hartuar si i tillë në zbatim të kërkesës nga autoritetet shëndetësore për rritjen e kapaciteteve analitike dhe dokumentuese të monitoruesve.

Manuali përshkruan procesin e monitorimit mbështetës si “mbikqyrje mbështetëse që ndihmon të arrihen objektivat (në rastin tonë zbatimi i kujdesit shëndetësor në banesë) dhe nuk është thjesht kontroll/verifikim i asaj që është bërë keq”<sup>1</sup> (OBSH, 2008). Monitorimi mbështetës është një proces që promovon cilësinë në të gjitha nivelet e sistemit shëndetësor duke forcuar marrëdhëniet brenda sistemit, me synim identifikimin dhe zgjidhjen e problemeve dhe kontributin për optimizimin e ndarjes së burimeve-promovimin e standardeve të larta, punë në ekip dhe komunikim më të mirë në të dy drejtimet<sup>2</sup>.

Manuali ofron parime, shembuj konkretë dhe mjete monitoruese në formën e listave të kontrollit për të orientuar ekipet e specialistëve të OSHKSH/NJVKSH/FSDKSH në monitorimin e zbatimit të Kujdesit Shëndetësor në Banesë nga strukturat e Kujdesit Shëndetësor Parësor (KSHP). Ai është organizuar në mënyrë të tillë që përshkruan procesin e monitorimit mbështetës dhe është i vlefshëm për përdorim nga monitoruesit e autoriteteve shëndetësore qendrore, rajonale dhe lokale në praktikën e tyre monitoruese. Ai përfshin të gjithë hapat e kryerjes së monitorimit mbështetës si një proces drejtues, ndihmues, trajnues dhe motivues<sup>3</sup> i profesionistëve të KSHP për zbatimin e Kujdesit Shëndetësor në Banesë.

Mjetet monitoruese që përmban Manuali janë hartuar bazuar në treguesit për monitorimin e zbatimit të Kujdesit Shëndetësor në banesë në Rregulloren e Brendshme të organizimit dhe funksionimit të KSHB<sup>4</sup> (miratuar nga MSHMS nr. Prot 188, datë 14.10.2021); Urdhëri i Ministrisë së Shëndetësisë Nr. 497; datë 22.09.2008 “Për Miratimin e udhëzuesit “Supervizimi mbështetës në kujdesin shëndetësor parësor”<sup>5</sup> dhe Udhëzimin Nr. 01, Datë 25.08.2022 “Mbi supervizimin tematik të Qendrave Shëndetësore”, Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor, Drejtoria Rajonale Tiranë, Drejtoria e Shërbimit Parësor<sup>6</sup>. Këto mjete janë hartuar në mënyrë të tillë që mund të përdoren si të plotë për monitorimin e zbatimit të KSHB ose mund të përdoren pjesërisht për monitorimin e një apo disa treguesve në përgjigje të qëllimit të monitorimit.

Mjetet monitoruese që përmban ky Manual për çdo hap të procesit monitorues, si të tilla ose të përshtatura mund t’i shtohen si shtojca listave në fuqi të mbikqyrjes mbështetëse të qendrave shëndetësore<sup>5,6</sup>, për përdorim nga autoritetet shëndetësore qendrore, rajonale dhe lokale në praktikën e tyre monitoruese të kujdesit shëndetësor parësor.

## Tabela e përmbajtjes

|   |    |
|---|----|
| Parathënie.....   | 2  |
| Planifikimi i vizitës monitoruese mbështetëse .....                             | 4  |
| Shembull 1: Shkresa e lajmërimit të vizitës monitoruese.....                    | 5  |
| Shembull 2: Programi i vizitës monitoruese .....                                | 6  |
| Kryerja e vizitës monitoruese në QSH.....                                       | 7  |
| Shkrimi dhe dorëzimi i raportit të vizitës monitoruese mbështetëse .....        | 12 |
| Shembull 3: Model raporti i vizitës monitoruese.....                            | 12 |
| Ndjekja pas vizitës monitoruese .....   | 14 |
| ___Indikatorët e monitorimit për zbatimin e KSHB .....                          | 16 |
| INFORMACION I PËRGJITHSHËM .....  | 19 |
| ___LISTË KONTROLLI NR 1 Organizimi i punës dhe funksionimi i KSHB në QSH.....   | 21 |
| LISTË KONTROLLI NR 2 Pajisjet mjekësore që përdoren gjatë ofrimit të KSHB. .... | 22 |
| LISTË KONTROLLI NR 3 Kqyrja e kartelës infermiere të pacientit.....             | 23 |
| LISTË KONTROLLI NR 4 Vizita monitoruese në banesë .....                         | 25 |
| REFERENCA .....   | 26 |
| SHKURTIME .....   | 27 |

## Planifikimi i vizitës monitoruese mbështetëse

Vizita monitoruese duhet të jetë e mirëplanifikuar. Një planifikim i mirë i vizitës monitoruese kërkon që:

### Monitoruesit në bashkëpunim me QSH-në që do të monitorohet të:

- a. **Vendosin objektiva të qarta.** Vendosja e objektivave është e rëndësishme sepse monitoruesit dhe Qendra Shëndetësore që do të monitorohet dinë se çfarë pritet dhe sesi të përgatiten. Për vendosjen e objektivave realiste monitoruesit shkëmbejnë informacion me QSH-në, *p.sh* lidhur me numrin e infermierëve dhe mjekëve që janë përfshirë në ofrimin e KSHB, numrin e pacientëve që përfitojnë kujdes shëndetësor në banesë, pajisjen me kopje fizike të kartelave infermiore, trajnimet e ekipit që ofron KSHB si (trajnimet për procedurat standarte infermiore, Grup Kolegësh për studimin e rregullores së brendshme etj) si dhe me praktikën e monitorimit të brendshëm në nivel QSH-je etj
- b. **Përcaktojnë aktivitetet gjatë vizitës monitoruese**
- c. **Rishikojnë raportet e mëparshme monitoruese** për të identifikuar çfarë duhej adresuar nga QSH-ja dhe masat që duheshin marrë që nga vizita e fundit monitoruese.

### Monitoruesit para vizitës monitoruese të:

- a. **shqyrtojnë mjetet e monitorimit** dhe përcaktojnë ato që do të përdoren gjatë vizitës monitoruese duke zgjedhur ato që përputhen me objektivat e vizitës monitoruese.
- b. **bëjnë përgatitjet administrative**, të tilla si: listojnë dhe grumbullojnë dokumentet e nevojshme për t'i marrë me vete në terren, *p.sh* Informacionin mbi QSH-në në lidhje me objektin e monitorimit, Planin e vizitës monitoruese, Mjetet e monitorimit në kopje të mjaftueshme, Rregulloren KSHB të miratuar nga QSH, Urdhrin e NJVKSH-së për vizitën monitoruese, manualin e procedurave standarte infermiore, laptop, stilolaps, shënjes etj
- c. **lajmërojnë QSH-në rreth detajeve të vizitës monitoruese**, data, plani i vizitës monitoruese etj. Shembulli i lajmërimit zyrtar jepet tek Shembulli 1: Shkresa e lajmërimit të vizitës monitoruese.

**QSH** që do të monitorohet duhet lajmëruar 10 ditë përpara datës së monitorimit duke i dërguar lajmërimin zyrtar. Shembulli i programit të vizitës monitoruese jepet tek Shembulli 2: Programi i vizitës monitoruese.

## Shembull 1: Shkresa e lajmërimit të vizitës monitoruese

Data: \_\_\_\_\_

Nga: NJVKSH \_\_\_\_\_

Për QSH: \_\_\_\_\_

### Lajmërim për vizitën monitoruese të zbatimit të Kujdesit Shëndetësor në Banesë.

Në kuadrin e mbështetjes dhe motivimit për zbatimin e Kujdesit Shëndetësor në Banesë nga strukturat e KSHP, NJVKSH \_\_\_\_\_ me datë \_\_\_\_\_ do të kryejë një vizitë monitoruese me qëllim monitorimin mbështetës të Kujdesit Shëndetësor në banesë në QSH \_\_\_\_\_.

Vizita monitoruese do të zhvillohet sipas programit *bashkëlidhur*. (*shif shembullin 2 lidhur me programin e vizitës monitoruese*)

Ju lutem konfirmoni dakortësinë ose jo të ditës së monitorimit brenda dy ditëve nga marrja e këtij lajmërimi.

**DREJTORI**

---

## Shembull 2: Programi i vizitës monitoruese

**NJVKSH** \_\_\_\_\_

**Qëllimi i vizitës monitoruese:** Monitorimi mbështetës i zbatimit të Kujdesit Shëndetësor në Banesë.

**QSH që monitorohet:** \_\_\_\_\_

**Periudha që monitorohet:** \_\_\_\_\_

**Data e monitorimit:** \_\_\_\_\_

**Ekipi i Monitoruesve:**

1. \_\_\_\_\_

2. \_\_\_\_\_

3. \_\_\_\_\_

### **Programi i vizitës monitoruese**

**8.30-8.45** Prezantim me shpjegim i qëllimit dhe programit të vizitës monitoruese Drejtorit, kryeinfermieres dhe ekipit të njësisë KSHB (koordinatore, mjek, infermier)

**8.45-9.00** Shoqërimi në vendin e punës dhe vënia në dispozicion e dokumenteve të nevojshme sipas qëllimit të paracaktuar.

**09.00-10.00** Vlerësimi i organizimit të punës dhe funksionimit të KSHB, sipas Listës së kontrollit nr 1.

**10:00 – 11:00** Verifikimi i pajisjeve dhe përdorimi i tyre sipas listës së kontrollit nr 2.

**11.00 - 12.00** Kqyrja e kartelave sipas listës së kontrollit nr 3.

**12.00 - 14.00** Kryerja e vizitës monitoruese në banesë sipas listës së kontrollit nr 4

**14.30 - 15.30** Përmbledhja e gjetjeve dhe përgatitja për gjetjet që do të ndahen me stafin e QSH-së

**15.30 - 16.00** Ndarja e gjetjeve të vizitës monitoruese me stafin e QSH-së, pyetje/komente. *Hapat e mëtejshëm.*

**16.00** Largimi nga QSH-ja

## Kryerja e vizitës monitoruese në QSH

Vizita monitoruese është pjesë e rëndësishme e monitorimit të jashtëm mbështetës. Gjatë vizitës monitoruese, monitoruesit demonstrojnë aftësi komunikimi dhe menaxhimi. Monitoruesit në mënyrë të veçantë përcjellin njohuri e aftësi dhe japin propozime që ndihmojnë/lehtësojnë zgjidhjen e problemeve. Ata zbatojnë modelin gjithëpërfshirës të komunikimit dhe përdorin mjetet e monitorimit për të dokumentuar gjetjet e vizitës.

Aktivitetet gjatë vizitës monitoruese përfshijnë:

### **Takimi me Drejtorin dhe ekipin e QSH-së**

Gjëja e parë që monitoruesit e jashtëm bëjnë pasi mbërrijnë në QSH është mbajtja e takimit me Drejtorin dhe ekipin e QSH-së. Ky takim duhet të jetë i shkurtër dhe të mos ndërpresë aktivitetin ditor të QSH-së. Qëllimi i takimit është prezantimi i qëllimit dhe sesi do të realizohet vizita monitoruese. Nëse Qendra Shëndetësore është e vogël, në këtë takim mund të marrë pjesë i gjithë ekipi që ofron KSHB. Nëse QSH-ja është e madhe në këtë takim mund të marrin pjesë: Drejtori, Kryeinfermieri, Koordinatorin e KSHB, një përfaqësi e Mjekëve të familjes dhe një përfaqësi e Infermierëve që janë përfshirë me ofrimin e KSHB. Gjatë këtij takimi monitoruesit duhet të shqyrtojnë arritjet dhe gjërat për përmirësim të lëna nga vizita e fundit monitoruese dhe të pyesin rreth progresit të bërë drejt këtyre përmirësimeve si dhe për probleme/vështirësi që mund të kenë dalë ndërkohë.

Në fund të takimit i gjithë ekipi duhet të jetë i vërtëdijshëm për objektivat e vizitës monitoruese dhe të ketë kuptuar sesi do të zhvillohet vizita monitoruese. Për monitoruesit dhe ekipin duhet të jetë e qartë se ku do të përqëndrohet vizita monitoruese.

### **Vënia në dispozicion të ekipit monitorues e personelit të caktuar dhe e mjeteve/dokumenteve të nevojshme**

Bazuar në objektivat e vizitës QSH vendos në dispozicion të monitoruesve dokumentet e mëposhtme: Rregullorja e Brendshme KSHB e miratuar nga QSH, kontratat e punës së personelit që ofron KSHB, planet javore të punës, data baza e pacientëve në formatin excel, formularët e dhënies hua të pajisjeve, akses në platformën e fondit ku janë raportuar vizitat, kartelat infermiore të pacientëve, manualin e procedurave standarte infermiore. Është e rëndësishme që observimi, verifikimet dhe marrja e informacionet të bëhen në një klimë besimi dhe ekipi i QSH-së të ndihen të qetë, të mbështetur dhe të nxiten për përgjigje të sinqerta.



## Vlerësimi i organizimit të punës për organizimin e punës dhe funksionimin e kujdesit të planifikuar në banesë.

Ky vlerësim kryhet nëpërmjet marrjes dhe analizimit të indikatorëve të mëposhtëm:

- **Ekzistenca e rregullores së brendshme:** Ky vlerësim kryhet nëpërmjet verifikimit nëse QSH disponon një Rregullore të brendshme të funksionimit të shërbimeve të planifikuara në banesë të përshtatur dhe miratuar nga QSH. Më tej kontrollohet nëse janë shënuar në brendësi të saj modeli i përzgjedhur i zbatimit të KSHB, lista emërore të personelit që është përfshirë në dhënien e këtij shërbimi. Pjesa operacionale e këtij dokumenti duhet të përditësohet një herë në vit (psh, lëvizjet e stafit, ndryshimi i modelit të zbatimit etj) si elementë të saj që janë subjekt ndryshimi gjatë kohës.
- **Kontratat e punës së personelit të përfshirë në ofrimin e KSHB:** Monitoruesit kontrollojnë nëse përshkrimet e punës që jepen në Aneksin 3, janë reflektuar tek kontratat e punës së personelit me QSH-në.
- **Përfituesit që marrin kujdes shëndetësor në banesë:** Ky informacion merret nga data baza e listës së pacientëve që merr KSHB. Përveç faktit që observohet nëse është krijuar databaza e pacientëve, gjithashtu merret informacion nga koordinatori nëse është përditësuar lista e pacientëve gjatë muajit të fundit. Më tej eksplorohehen shkaqet e reduktimit të numrit të pacientëve si dhe diskutohet nëse ka pacientë të cilët kanë nevojë por nuk janë përfshirë në këtë listë. Njëkohësisht, në raste të shtimit të numrit të pacientëve diskutohet nëse QSH ka burimet (*njerëzore, pajisje, mjete, etj*) e duhura për përballimin e ngarkesës së punës. Në rast se jo, të diskutohen mundësitë për mbështetje.
- **Planifikimi i vizitave:** Monitoruesit vlerësojnë nëse vizitat ofrohen në mënyrë të planifikuar dhe jo (psh nëse kryhen vetëm kur i kërkon familjari/pacienti). Për këtë observohen planet e punës me datën, orën dhe emrat e pacientëve dhe të infermierëve respektivë. Për më shumë kontrollohet nëse është shënuar edhe arsyeja e vizitës së ardhshme.
- **Ekzistenca e kartelës infermiere:** A është hapur kartelë infermiere për çdo pacient? A korrespondon numri i kartelës infermiere me numrin e kartelës së pacientit që menaxhon mjeku?
- **Raportimi i vizitave:** A janë raportuar saktë vizitat në platformën elektronike të Fondit? Kush i hedh vizitat në platformë dhe a ka nevojë për përmirësim të procesit?

- **Numri i vizitave:** A korrespondon numri i vizitave të raportuara në platformën elektronike me numrin e vizitave të raportuara në kartelë? Cili është raporti i vizitave për pacient gjatë një muaji? A janë raportuar 100% e pacientëve të paktën me një vizitë në muaj?
- **Aftësitë klinike të personelit infermieror:** A janë trajnuar i gjithë personeli infermieror për performimin e procedurave standarte infermierore? A është ngritur grupi i kolegëve për qendrën shëndetësore që po monitorohet, lidhur me zbatimin e Rregullores së Brendshme të KSHB?
- **Numri i pacientëve të referuar tek Shërbimet Sociale:** Sa pacientë janë referuar tek shërbimet sociale? Monitoruesit verifikojnë me formularët e plotësuar sipas Aneksit 2.

**Prania e pajisjeve mjekësore dhe paramjekësore.** Observimi në dhomën e KSHB për praninë e pajisjeve mjekësore dhe paramjekësore për ofrimin e kujdesit shëndetësor në banesë. Pajisjet specifike për të bërë këtë vlerësim janë në Listën e Supervizimit Tematik nr 2. Në kolonën e mjetit që verifikohet shënohet PO nëse gjendet dhe JO nëse nuk gjendet i pranishëm. Verifikimi kryhet me observim si dhe duke kontrolluar me formularin për dhënien hua të pajisjeve sipas Aneksit 4. Ndërsa në kolonën "Përdorur të paktën një herë", vlerësohet nëse mjetet e vëna në dispozicion të QSh-së vihen në përdorim ose jo.

**Kqyrja e kartelave infermierore të pacientit.** Kqyrja e kartelave do të bëhet në vendin që caktohet nga Drejtori i QSH-së. Monitoruesit duhet të punojnë të qetë dhe pa u shqetësuar nga aktiviteti që ndodh në QSH. Për këtë pas takimit me stafin, Drejtori i QSH-së shoqëron monitoruesit në vendin e punës të caktuar për to. Numri i kartelave që sugjerohen që të shqyrtohen është sa 10% e numrit të kartelave të pacientëve që janë identifikuar nga QSH për të marrë kujdes shëndetësor në banesë dhe gjithashtu sipas gjykimit të ekipit të monitoruesve.

**Parime të zgjedhjes së kartelave që do të kontrollohen:**

- Rregulli i zgjedhjes së rastësishme të kartelave infermierore të pacientëve që marrin kujdes shëndetësor në banesë: psh zgjidhet numri nga 1 deri në 10 që do të përdoret për zgjedhjen e kartelave për periudhën që do të monitorohet.
- Drejtori i QSH-së vë në dispozicion të monitoruesve të gjithë listën e pacientëve që ndodhet në data bazën në format excel. Duke ju referuar kësaj liste monitoruesit përzgjedhin kartelat duke përdorur rregullin e paracaktuar të zgjedhjes së rastësishme.
- Monitoruesit zgjedhin kartelat në numrin e paracaktuar tek programi i monitorimit.
- Ekipi i QSH-së do të kujdeset që të kontrollohen kartela të ndryshme në çdo vizitë monitoruese.

- Pas përzgjedhjes së kartelave dhe vënies në dispozicion, monitoruesit bëjnë shqyrtimin e tyre duke përdorur listë kontrollin nr 3.

#### **Kqyrja e kartelave synon të vlerësojë dokumentimin e vizitave nëpërmjet:**

- verifikimit të plotësisë të rubrikave të saj
- dokumentimit të gjykimit klinik bazuar në gjetjet e ekzaminimit
- dokumentimit të planit të kujdesit të ofruar

Mënyra e dokumentimit të rubrikave të kartelës jepet më poshtë:

- **Anamneza**
  - gjendja shëndetësore/vlerat e parametrave prej tyre, ushqyerja sipas vakteve, marrja e medikamenteve
  - ushqyerja (mengjes/drekë, darkë/zemrat)
  - marrja e medikamenteve (llojet/dozat/mënyra e marrjes)
  - urinimi: (pa kateter: me ose pa fenomene dizurike); (me kateter: data, ora e ndërrimit të qeses, sasia, ngjyra)
  - defekimi (shpeshtësia)
- **Rezultatet e ekzaminimit objektiv**
  - gjetjet e vlerësimit nga koka tek këmbët
  - vlerat e parametrave vitalë (TA, P, Resp, SPO2, T)
  - ndryshimet e kushteve shëndetësore të pacientit
- **Procedura Infermierore që kreu**
  - mënyra sesi e toleroi pacienti procedurën infermierore
  - këshillim për pacientin/familjarin
  - pacienti ra dakord ose jo me instruksionet e dhëna me anë të këshillimit

#### **Vizita monitoruese në banesën e pacientit**

Qëllimi i vizitës monitoruese në banesën e pacientit është vlerësimi me mbështetje i cilësisë së shërbimeve për aftësimin e vazhdueshëm të personelit të njësisë së Kujdesit Shëndetësor në Banesë. Përzgjedhja e pacientit/ëve do të bëhet sërish në mënyrë të rastësishme në listën e pacienëve. Koordinatorja e KSHB do të kujdeset që të vizitohen pacientë të ndryshëm. Sugjerohet që vizitën monitoruese në banesë t'a kryejë vetëm një monitorues, në mënyrë që të mos ketë mbingarkesë të numrit të personave në ambjentin e banesës. Gjatë vizitës monitoruesi vetëm observon dhe nuk ndërhyr fare. Madje duhet të përpiqet

maksimalisht që të mos e shpërqëndrojë apo emocionojë infermierën e cila po kryen vizitën. Ai vlerëson cilësinë e vizitës duke vlerësuar elementët më poshtë:

- Sjellja dhe komunikimi me etikë të lartë profesionale sipas kodit etik dhe deontologjik
- siguron privatësi për pacientin
- marrja e informacionit të detajuar nga pacienti apo familjari me ankesat e pacientit, vlerat e parametrave vitalë të matura prej tyre, ushqyerjen e pacientit, marrjen e medikamenteve, urinimin, defekimin,
- Ekzaminimi infermieror nga koka tek këmbët
- Procedura/t infermirore e/të ofruara janë ose jo në përgjigje të situatës shëndetësore
- Nëse procedura e standartizuar infermirore performohet sipas hapave të paraqitur tek manuali i procedurave standarte infermirore (të cilin monitoruesi e merr me vete).
- A ofron infermierja këshillim/udhëzime për pacientin/familjarin në përgjigje të situatës shëndetësore që paraqet pacienti në ditën e vizitës?
- A është adresuar nevoja për kujdes social në familjen që vizitoni (nëse ka)?

#### **Takimi përmbyllës me Drejtorin dhe stafin e QSH-së që është përfshirë në ofrimin e KSHB.**

Në mbyllje të vizitës monitoruese monitoruesit duhet të takojnë ekipin që ofron KSHB me qëllim:

- për t'i përgëzuar për progresin e bërë nga vizita e fundit monitoruese
- për të ndarë gjetjet e përmbledhura (nga observimi dhe kqyrja e kartelave) dhe bazuar në to rekomandimet për përmirësim
- për të identifikuar prioritetet për ndërhyrje dhe për të diskutuar ndonjë çështje që kërkon vëmendje të menjëhershme
- për të diskutuar burimet në dispozicion për zgjidhjen e problemeve
- për të dakortësuar afate kohore realiste për përbushjen e veprimeve që duhen ndërmarrë

Gjithashtu mund të planifikojnë vizitën tjetër monitoruese.

## Shkrimi dhe dorëzimi i raportit të vizitës monitoruese mbështetëse

Raporti i vizitës monitoruese është një përmbledhje me gjetjet, dhe veprimet që duhen ndërmarrë me afate kohore dhe është dëshmi që vizita monitoruese ka ndodhur. Raporti duhet shkruar sa më shpejt pas vizitës dhe i dërgohet QSH-së brenda 10 ditëve nga data e kryerjes së vizitës monitoruese. Format i raportit varet nga çështjet e monitoruara gjatë vizitës monitoruese. Megjithatë, formati i raportit duhet të përfshijë gjetjet që janë përfutur nga përdorimi i mjeteve monitoruese me ekipin e QSH-së në ambientet e QSH-së, në banesën e pacientit, shënimet që u lanë aty, rekomandimet e bëra nga ekipi monitorues nga NJVKSH-së/Fondi, dhe personat përgjegjës për adresimin e rekomandimeve apo gjetjeve. Shembulli i formatit të Raportit të vizitës monitoruese jepet tek shembulli 3 më poshtë:

### Shembull 3: Model raporti i vizitës monitoruese

NJVKSH \_\_\_\_\_ në zbatim të Urdhërit Nr.....datë \_\_\_\_\_ ka kryer me datë  
\_\_ / \_\_ / 202\_\_ vizitën monitoruese në QSH.

Qëllimi i vizitës: \_\_\_\_\_

Objektivat specifikë:

1. \_\_\_\_\_
2. \_\_\_\_\_
3. \_\_\_\_\_

Periudha e monitoruar është nga \_\_\_\_\_ deri më \_\_\_\_\_.

**Monitorimi është bërë nga ekipi si më poshtë:**

1. emër, mbiemër, pozicion, kontakt
2. emër, mbiemër, pozicion, kontakt
3. emër, mbiemër, pozicion, kontakt

Vizita monitoruese është bërë sipas programit (shembulli 2), bashkëlidhur raportit si Aneks.

**Stafi shëndetësor pjesëmarrës në procesin e monitorimit sipas objektivave specifike:**

1. Drejtori i QSH
2. Koordinator i KSHB-së,
3. Infermierë të shërbimit në banesë.

**Përshkrim i procesit:**

Përshkruani procesin e monitorimit. Çfarë vëzhguat, çfarë biseduat, çfarë vlerësuat, etj.

### **Gjetjet**

Përmbliidhen gjetjet bazuar tek observimi i rregullores së brendshme KSHB, kontratat e punës së personelit, databazës së pacientëve, verifikimit të pajisjeve, analizës së treguesve sasiorë të marrë nga Evizita, vlerësimin të shërbimeve bazike apo të avancuara, kqyrja e kartelave dhe observimi gjatë vizitës monitoruese në banesë. Fillimisht hidhen gjetjet për treguesit që përmbushen më mirë dhe më pas ato që përmbushen më pak.

### **Diskutimi**

Në këtë seksion analizohen gjetjet *psh* progresi kundrejt zbatimit të rekomandimeve të vizitës së fundit monitoruese, analizohen/përshkruhen faktorët që mund të kenë ndikuar pozitivisht dhe faktorët që mund të pengojnë/vonojnë përmbushjen e të gjithë treguesve *psh* të lidhur me infrastrukturën fizike, pajisjet, burimet njerëzore, me organizimin e brendshëm të QSH-së ose shkaqe/faktorë të tjerë lokalë dhe të përkohshëm si dhe të tjerë sipas rastit.

### **Rekomandimet**

Bazuar në gjetjet dhe në specifikat e QSH-së jepen rekomandime të zbatueshme/veprime që duhen ndërmarrë me afate kohore realiste për përmbushje. Rekomandime të zbatueshme janë rekomandime që ndikojnë në përmirësimin e zbatimit të kujdesit shëndetësor në banesë dhe zbatimi i tyre varet kryesisht nga QSH-ja *psh*:

- për aspektet specifike të zbatimit të KSHB që kanë nevojë për përmirësim,
- zhvillimi periodik i monitorimit mbështetës të brendshëm nga QSH,
- zhvillimi i aktiviteteve të edukimit në vazhdim në QSH (trajnime klinike dhe Grupet e Kolegëve) dedikuar rritjes së njohurive dhe aftësive të veçanta për zbatimin e KSHB,
- organizimi në mënyrë sistematike i takimeve në nivel ekipi që ofron KSHB.

Këtu jepen dhe veprime zbatimi i të cilave nuk është në dorën e QSH-së , por për të cilat është e nevojshme që monitoruesit të nxisin zbatimin e tyre, *psh*;

- të nxisin/të llobojnë për zgjidhjen e problemeve të lidhura me burimet (burimet njerëzore, infrastrukturë fizike, pajisje etj) me autoritetet shëndetësore lokale, rajonale, qendrore, pushtetin lokal ose me ndonjë burim/institucion tjetër jo publik.

## Ndjekja pas vizitës monitoruese

- **Informimi i autoriteteve përkatëse:** Ekipi i monitoruesve duhet të sigurohet që autoritetet shëndetësore lokale dhe rajonale, dhe personeli i QSH-ve të informohen siç duhet për aktivitetet në terren. Mbajtja e sa më shumë njerëzve të informuar siguron mbështetje gjatë mobilizimit të burimeve për lehtësimin dhe zgjidhjen e problemeve.
- **Ndjekja për zbatimin e rekomandimeve.** Aspekti i ndjekjes synon që masat e identifikuara për përmirësimin e zbatimit të KSHB të ndërmerren/zbatohen nga QSH-ja. Monitoruesit nuk duhet të presin deri në vizitën tjetër monitoruese për të parë nëse situata është përmirësuar. Ato duhet të jenë bashkëpunëtorë të QSH-së në zbatimin sa më shpejt të jetë e mundur të masave të rekomanduara. Disa masa mund të jetë e nevojshme të nxiten për zbatim nga monitoruesit, psh nxitja/lobimi për zgjidhjen e problemeve logjistike (infrastrukturë fizike, pajisje etj) me autoritetet shëndetësore lokale, rajonale, qendrore, pushtetin lokal ose me ndonjë burim/institucion tjetër jo publik. Lidhur me masat nën përgjegjësinë e QSH-së, monitoruesit duhet të komunikojnë në mënyrë periodike me QSH-në për të njohur sa progres është bërë dhe për të ofruar inkurajim. Komunikimi mund të jetë me telefon ose me ndonjë vizitë të shkurtër për të ndjekur dhe nxitur progresin e zbatimit të masave të dakortësuara. Ndjekja mund të lehtësohet përmes hartimit të hartës së proceseve për adresimin e rekomandimeve.

*Një model mund të jetë sipas tabelës më poshtë:*

| Nr. | Gjetja nga monitorimi | Adresimi i gjetjes (çfarë është bërë) | Afati kohor për adresim të gjetjes | Personi/at përgjegjës për adresim të gjetjes | Komente |
|-----|-----------------------|---------------------------------------|------------------------------------|--|---------|
|     |                       |                                       |                                    |  |         |
|     |                       |                                       |                                    |  |         |
|     |                       |                                       |                                    |  |         |
|     |                       |                                       |                                    |  |         |

**Indikatorët e monitorimit  
për zbatimin e KSHB**



## Indikatorët e monitorimit për zbatimin e KSHB

| Nr | Indikator   | Përkufizimi<br>(si është llogaritur?)  | Objektivi i synuar<br>(cila është vlera e synuar?)   | Burimi nga<br>përftohet<br>(ku e gjejmë këtë<br>tregues?) | Përgjegjës<br>(kush do t'a masë<br>atë?) |
|----|---|--|--|---|--|
| 1  | Rregullorja e Brendshme KSHB                          | Rregullore në të cilën janë reflektuar organigrama e QSH-së, modeli i zbatimi, lista emërore e personelit që ofron KSHB.   | Miratimi i Rregullores nga Drejtori i QSH-së   | Drejtorja e QSH-së  | Specialisti NJVKSH/FSDKSH                |
| 2  | Kontrata personale të personelit që ofron KSHB        | Kontratat e punës së koordinatorit, infermierët, mjekët që ofron KSHB përmbajnë detyrat e reja të punës ( <i>sipas Aneks 3 - Përshkrimet e punës së personelit që ofron KSHB</i> ) | Kontratat e përditësuara të firmosura nga personeli dhe Drejtori QSH-së                                  | Burimet njerëzore në Drejtorinë e QSH-së                  | Specialisti NJVKSH/FSDKSH                |
| 3  | Data baza e pacientëve                                | Lista e pacientëve që merr KSHB, e përditësuar çdo fund muaji.   | Listë pacientësh e përditësuar çdo muaj  | Data baza që administrohet nga Koordinatorja KSHB         | Specialisti NJVKSH/FSDKSH                |
| 4  | Planifikimi i vizitave                                | Vizitat në banesë të kryhen në mënyrë proaktive dhe të planifikuar nga infermieret   | Plani i punës javor i plotësuar  | Plani i punës që mban Koordinatorja KSHB                  | Specialisti NJVKSH/FSDKSH                |
| 5  | Kartela Infermiore                                    | Kartela infermiore e pacientit   | Çdo pacient i data bazës të ketë kartelë infermiore të hapur   | Koordinatorja KSHB  | Specialisti NJVKSH/FSDKSH                |
| 6  | Raportimi i vizitave në sistemin elektronik të Fondit | Vizitat raportohen në platformën e Fondit hidhen   | Numri i vizitave të raportuara në Fond duhet të përputhet me numrin e vizitave të përshkruara në kartelë | Platforma elektronike e Fondit                            | Specialisti NJVKSH/FSDKSH                |
| 7  |   | Formë edukimi në vazhdim midis anëtarëve të njësisë KSHB që synon takime periodike lidhur me studimin e Rregullores KSHB dhe ecurinë e rasteve që ndjek secili.                    | Të jetë ngritur Grupi i Kolegëve për zbatimin e Rregullores KSHB   | Koordinatorja KSHB  | Specialisti NJVKSH/FSDKSH                |

| <b>Nr</b> | <b>Indikatori</b>   | <b>Përkufizimi<br/>(si është llogaritur?)</b>  | <b>Objektivi i synuar<br/>(cila është vlera e synuar?)</b>                               | <b>Burimi nga përtohet<br/>(ku e gjejmë këtë tregues?)</b> | <b>Përgjegjës<br/>(kush do t'a masë atë?)</b> |
|-----------|---|--|--|--|---|
|           | Grupet e kolegëve   |  |  |  |   |
| 8         | Numri i përfituesve KSHB                                      | Numri i pacientëve të identifikuar nga QSH për të marrë shërbime shëndetësore në banesë (pacientë kronikë dhe të moshuar që kanë pikëzim poshtë 40)  | 100% e pacientëve kronikë dhe të moshuar 65+ që kanë pikëzim poshtë 40.                  | Data baza pacientëve KSHB-QSH                              | Specialisti NJVKSH/FSDKSH                     |
| 10        | Numri i vizitave të kryera                                    | Numri i vizitave të kryera gjatë një periudhe të caktuar   | Në varësi të situatës shëndetësore që paraqet pacienti                                   | Platforma FSDKSH   | Specialisti NJVKSH/FSDKSH                     |
| 11        | Numri i pacientëve të referuar tek Shërbimet Sociale (bashki) | Numri i rasteve të referuara tek Shërbimet Sociale brenda një periudhe të caktuar. Verifikimi bëhet nëpërmjet Formularëve të plotësuar të referimit tek Shërbimet sociale ( <i>Aneks 2 – Formulari i referimit tek Shërbimet Sociale tek Rregullorja KSHB</i> ). | 100% e pacientëve në nevojë për shërbime sociale   | QSH  | Specialisti NJVKSH/FSDKSH                     |
| 12        | Plotësimi i formularit Infermieror                            | Formulari i vlerësimit Inf i plotësuar sipas kërkesave   | Secila rubrikë e formularit të jetë plotësuar sipas kërkesave                            | Kqyrja e formularit të vlerësimit infermieror              | Specialisti NJVKSH/FSDKSH                     |
| 13        | Anamneza e plotësuar  | Çfarë referon pacienti *   | Secila kartelë të ketë të dokumentuar anamnezën e pacientit/familjarit*                  | Kqyrja e kartelës  | Specialisti NJVKSH/FSDKSH                     |
| 14        | Gjetjet e ekzaminimit fizik                                   | Observimet infermiore gjatë vizitës  | Secila kartelë të ketë të dokumentuar gjetjet e ekzaminimit objektiv nga koka tek këmbët | Kqyrja e kartelës  | Specialisti NJVKSH/FSDKSH                     |

| <b>Nr</b> | <b>Indikatori</b>  | <b>Përkufizimi<br/>(si është llogaritur?)</b>   | <b>Objektivi i synuar<br/>(cila është vlera e synuar?)</b>  | <b>Burimi nga përfitohet<br/>(ku e gjejmë këtë tregues?)</b> | <b>Përgjegjës<br/>(kush do t'a masë atë?)</b> |
|-----------|--|---|---|--|---|
| 15        | Shërbimet e ofruara  | Procedura infermiere e kryer  | Secila kartelë të ketë të dokumentuar shërbimet e ofruara   | Kqyrja e kartelës  | Specialisti NJVKSH/FSDKSH                     |
| 16        | Procedura e kryer sipas manualit të procedurave standarte infermiere | Observim i cili vlerëson cilësinë e ofrimit të vizitës e plotë sipas të gjithë pjesëve: me marrjen e anamnezës, | Procedura të kryhet në përputhje me Manualin e Proce Standarte Infermiere                         | Vizita monitoruese në banesën e pacientit                    | Specialisti NJVKSH                            |
| 17        | Ofrimi i seancave keshilluese gjatë vizitës                          | Informacion i perditësuar rreth sëmundjes, dhe këshilla për vetë-kujdes   | Të ofrohet informacion i plotë gjatë vizitës lidhur me sëmundjen dhe këshillimin për vetë-kujdes. | Vizita monitoruese në banesën e pacientit                    | Specialisti NJVKSH                            |

**Tabela 1: Të dhënat që gjenerohen në sistemin elektronik të Fondit**

| <b>Nr</b> | <b>Muaji</b> | <b>Nr i pacientëve të vizituar</b> | <b>Numri i vizitave të kryera</b> | <b>Numri i pacientëve të referuar tek Shërbimet Sociale (bashki)</b> | <b>Llojet e shërbimeve të ofruara</b> |
|-----------|--------------|------------------------------------|-----------------------------------|--|---------------------------------------|
| 1         | Janar 23     |                                    |                                   |  |                                       |
| 2         | Shkurt 23    |                                    |                                   |  |                                       |

INFORMACION I PËRGJITHSHËM

QENDRA SHËNDETËSORE \_\_\_\_\_

|   |  |  |   |
|---|--|--|---|
| <b>Bashkia</b>  |  | <b>Popullata që mbulon</b>   |   |
| <b>Njësia Administrative</b>                                  |  | Zona që mbulon QSH (lagje/lagjet; fshat/fshatrat etj).<br>Përshkruaj sipas pikave ambulatorie) |   |
| <b>NJKSH</b>  |  | Data e vizitës së fundit të monitorimit nga NJVKSH   | __/__/202__   |
|   |  | Ka raport monitorimi pranë QSH nga vizitat e fundit  | PO <input type="checkbox"/> JO <input type="checkbox"/> |
| <b>Distanca nga NJVKSH (km)</b>                               |  | Data e vizitës monitoruese   | __/__/202__   |
| <b>Ekipi monitorues</b><br><i>(Emër Mbiemër)</i>              | 1-   | 2-   |   |
|   | 3-   | 4-   |   |
| <b>Tematika e monitorimit</b>                                 |  |  |   |
| <b>Qendra Shëndetësore</b>                                    | Përshkruaj llojin e QSH-së (bazike, 24 h, socio-shëndetësore), turnet dhe zonat e mbulimit si dhe organizimin e punës së bërë nga titullari për ofrimin e shërbimit shëndetësor: |  |   |
| Personeli qe mungon ditën e monitorimit dhe arsyet e mungesës |  |  |   |

## **MJETET MONITORUESE**

### ***LISTAT E KONTROLLIT***

## LISTË KONTROLLI NR 1 Organizimi i punës dhe funksionimi i KSHB në QSH

Qendra Shëndetësore: \_\_\_\_\_

Datë: \_\_/\_\_/\_\_\_\_\_

| Nr | Përshkrimi i elementëve të monitorimit   | PO ose JO | Komente |
|----|--|-----------|---------|
| 1  | A ekziston Rregullorja e Brendshme KSHB në QSH?  |           |         |
| 2  | A janë reflektuar në kontrata përshkrimet e punës së ekipit që ofron kujdes Shëndetësor në banesë (koordinatori KSHB, infermierët, mjekët përgjegjës të pacientëve që marrin KSHB në zonën e tyre të mbulimit) <i>(Referojuni Aneksit 3 të Rregullores KSHB)</i>     |           |         |
| 3  | A është përditësuar gjatë muajit të fundit lista e pacientëve që merr shërbime KSHB? <i>(Referojuni databazës në formatin excel që ka prodhuar QSH)</i>  |           |         |
| 4  | A kryhen vizita në mënyrë të planifikuar në banesë në bazë të Planit të Punës javor: Data/Ora/Arsyeja e vizitës? <i>(Referojuni Aneksit 8- Planit të Punës javor të Rregullores KSHB)</i>  |           |         |
| 5  | A është hapur kartelë infermirore për çdo pacient?   |           |         |
| 6  | A janë raportuar të gjitha vizitat në sistemin elektronik të Fondit? <i>(verifikoni me vizitat e përshkruara në kartelën e pacientit)</i>  |           |         |
| 7  | A janë ngritur grupet e kolegëve lidhur me zbatimin e Rregullores së Brendshme KSHB?   |           |         |
| 8  | A janë mbuluar 100% e pacientëve me të paktën një vizitë në muaj? <i>(analizoni të dhënat që gjenerohen nga platforma e Fondit- Tabela nr 1)</i>   |           |         |
| 9  | A janë referuar 100% e pacientëve në nevojë për shërbime sociale tek Njësia e Shërbimeve Sociale në Bashki/? <i>(verifikoni me formularët e plotësuar për referim tek Njësia e vlerësimit të nevojave dhe referimit – Aneksi 2 të rregullores së Brendshme KSHB)</i> |           |         |

**LISTË KONTROLLI NR 2 Pajisjet mjekësore që përdoren gjatë ofrimit të KSHB.**

*Shënim: Kjo listë mjetesh verifikohet në vend si dhe nëpërmjet kontrollit të formularëve të plotësuar të "Dhënie hua e pajisjeve në Aneksin 11 të Rregullores KSHB".*

**Qendra Shëndetësore:** \_\_\_\_\_

**Datë:** \_\_/\_\_/\_\_\_\_\_

| Nr | Përshkrimi i artikullit                         | Ekziston                 | Funksionon               | Konsumuar                | Përdorur të paktën 1 herë |
|----|---|--------------------------|--------------------------|--------------------------|---------------------------|
|    |   | Përgjigjuni<br>PO ose JO | Përgjigjuni<br>PO ose JO | Përgjigjuni<br>PO ose JO | Përgjigjuni<br>PO ose JO  |
| 1  | Karrige tualeti dhe dushi me rrota              |                          |                          |                          |                           |
| 2  | Paterica me mbështetje bërryli                  |                          |                          |                          |                           |
| 3  | Dyshek me ajër anti dekubitus                   |                          |                          |                          |                           |
| 4  | Uturak për në shtrat                            |                          |                          |                          |                           |
| 5  | Urinar për meshkuj                              |                          |                          |                          |                           |
| 6  | Mbështetëse për të ecur                         |                          |                          |                          |                           |
| 7  | Rrip mesi për transferim të pacientit           |                          |                          |                          |                           |
| 8  | Legen për larjen e kokës së pacientit në shtrat |                          |                          |                          |                           |
| 9  | Set për kujdesin e thonjve të këmbës            |                          |                          |                          |                           |
| 10 | Set për mikrokirurgji                           |                          |                          |                          |                           |
| 11 | Garza të medikamentuara - Duoderm               |                          |                          |                          |                           |
| 12 | Tub nazal për oksigjenim                        |                          |                          |                          |                           |
| 13 | Aparat nebulizator                              |                          |                          |                          |                           |
| 14 | Maske aerezoli                                  |                          |                          |                          |                           |
| 15 | Teste të shpejta për analize urine              |                          |                          |                          |                           |
| 16 | Vigon (kateter venoz)                           |                          |                          |                          |                           |
| 17 | Pajisje për ushtrimet e frymëmarrjes            |                          |                          |                          |                           |
| 18 | Kateter urinar latex/silicon                    |                          |                          |                          |                           |
| 19 | Sonda nazogastrike                              |                          |                          |                          |                           |
| 20 | Karrocë me rrota                                |                          |                          |                          |                           |
| 21 | Aparat për klizmë                               |                          |                          |                          |                           |
| 22 | Garza sterile                                   |                          |                          |                          |                           |
| 23 | Metër letër                                     |                          |                          |                          |                           |
| 24 | Pompë për trajtim limfedeme                     |                          |                          |                          |                           |
| 25 | Manshetë për trajtimin e limfedemës krah        |                          |                          |                          |                           |
| 26 | Mansheta për trajtimin e limfedemës këmbë       |                          |                          |                          |                           |
| 27 | Aparat EKG portabël                             |                          |                          |                          |                           |
| 28 | Barrela me doreza                               |                          |                          |                          |                           |

## LISTË KONTROLLI NR 3 Kqyrja e kartelës infermiore të pacientit

**Shënim:** Informacioni përfitohet nëpërmjet kqyrjes së kartelave infermiore të pacientit

Qendra Shëndetësore: \_\_\_\_\_ Data \_\_\_\_\_

| Treguesit e monitorimit të zbatimit të KSHB  | Vlerëso nëse informacioni është në kartelën e pacientit me PO ose JO |    |    |    |    |    |    |    |    |     | Mangësi të konstatuara | Rekomandime |
|--|--|----|----|----|----|----|----|----|----|-----|------------------------|-------------|
|  | K1   | K2 | K3 | K4 | K5 | K6 | K7 | K8 | K9 | K10 |                        |             |
| <b>Kartela e pacientit duhet të ketë të dokumentuar:</b>   |  |    |    |    |    |    |    |    |    |     |                        |             |
| <b>Gjeneralitetet</b>  |  |    |    |    |    |    |    |    |    |     |                        |             |
| <b>1.</b> Formulari i vlerësimit infermior i plotësuar sipas kërkesave   |  |    |    |    |    |    |    |    |    |     |                        |             |
| <b>2 Marrja e anamnezës</b>  |  |    |    |    |    |    |    |    |    |     |                        |             |
| <b>2.1</b> E dokumentuar në përshkrimin në kartelë të vizitës të asaj dite   |  |    |    |    |    |    |    |    |    |     |                        |             |
| <b>2.2</b> Ankesat   |  |    |    |    |    |    |    |    |    |     |                        |             |
| <b>2.3</b> Ushqyerja sipas vakteve: (mengjes/drekë, darkë/zemrat)  |  |    |    |    |    |    |    |    |    |     |                        |             |
| <b>2.4</b> Marrja e medikamenteve (llojet/dozat/mënyra e marrjes)  |  |    |    |    |    |    |    |    |    |     |                        |             |
| <b>2.5</b> Urinimi: (pa kateter: me ose pa fenomene dizurike); (me kateter: data, ora e nderrimit te qeses, sasia, ngjyra) |  |    |    |    |    |    |    |    |    |     |                        |             |
| <b>2.6</b> Defekimi (shpeshtësia)  |  |    |    |    |    |    |    |    |    |     |                        |             |
| <b>3. Rezultatet e ekzaminimit objektiv</b>  |  |    |    |    |    |    |    |    |    |     |                        |             |
| <b>3.1</b> Gjetjet e vlerësimit nga koka tek këmbët  |  |    |    |    |    |    |    |    |    |     |                        |             |
| <b>3.2</b> Vlerat e parametrave vitalë (TA, P, Resp, SPO2, T)  |  |    |    |    |    |    |    |    |    |     |                        |             |



| Treguesit e monitorimit të zbatimit të KSHB   | Vlerëso nëse informacioni është në kartelën e pacientit me PO ose JO |    |    |    |    |    |    |    |    |     | Mangësi të konstatuara | Rekomandime |  |
|---|--|----|----|----|----|----|----|----|----|-----|------------------------|-------------|--|
|   | K1   | K2 | K3 | K4 | K5 | K6 | K7 | K8 | K9 | K10 |                        |             |  |
| <b>4. Plani i kujdesit te individualizuar</b>   |  |    |    |    |    |    |    |    |    |     |                        |             |  |
| <b>4.1</b> Lloji i procedurave të kryera në përgjigje të situatës shëndetësore                        |  |    |    |    |    |    |    |    |    |     |                        |             |  |
| <b>4.2</b> Mënyra sesi e toleroi pacienti procedurën infermierore                                     |  |    |    |    |    |    |    |    |    |     |                        |             |  |
| <b>4.3</b> Këshillim/Instruksione per pacientin/familjarin  |  |    |    |    |    |    |    |    |    |     |                        |             |  |
| <b>4.4</b> Pacienti dhe/ose familjari ra dakord ose jo me instruksionet e dhëna me anë të këshillimit |  |    |    |    |    |    |    |    |    |     |                        |             |  |
| <b>Komente</b>  |  |    |    |    |    |    |    |    |    |     |                        |             |  |

## LISTË KONTROLLI NR 4 Vizita monitoruese në banesë

Qëllimi i vizitës monitoruese në banesën e pacientit është vlerësimi me mbështetje i cilësisë së shërbimeve për aftësimin e vazhdueshëm të personelit të njësisë së Kujdesit Shëndetësor në Banesë.

Qendra Shëndetësore: \_\_\_\_\_

Datë: \_\_\_\_/\_\_\_\_/\_\_\_\_

| Nr | Përshkrimi i elementëve të monitorimit   | PO ose JO | Komente |
|----|--|-----------|---------|
| 1  | A komunikon me etikë infermierja me pacientin dhe familjarët e tij/saj?  |           |         |
| 2  | A merr infermierja informacion të detajuar nga pacienti dhe familjari lidhur me ankesat e pacientit?   |           |         |
| 3  | A merr infermierja informacion të detajuar nga pacienti dhe familjari lidhur me vlerat e parametrave vitalë të matura prej tyre?   |           |         |
| 4  | A merr infermierja informacion të detajuar lidhur me ushqyerjen e pacientit sipas vakteve: (mëngjes/drekë, darkë/zemrat)   |           |         |
| 5  | A merr infermierja informacion të detajuar lidhur me medikamentet (llojet/dozat/mënyra e marrjes) dhe ai i pi pacienti rregullisht apo jo?                               |           |         |
| 6  | A merr infermierja informacion të detajuar lidhur me urinimin: (pa kateter: me ose pa fenomene dizurike) dhe (me kateter: data, ora e ndërrimit të qeses, sasia, ngjyra) |           |         |
| 7  | A merr infermierja informacion të detajuar lidhur me defekimin (shpeshtësia, konsistenca)  |           |         |
| 8  | A kryen infermierja vlerësimin infermieror nga koka tek këmbët?  |           |         |
| 9  | A mat infermierja parametrat vitalë (TA, P, Resp, SPO2, Temp)  |           |         |
| 10 | A ofron infermierja procedurat infermierore në përgjigje të situatës shëndetësore?   |           |         |
| 11 | A aplikohet procedura e standardizuar infermierore sipas hapave të treguar në manualin e procedurave standarte Infermierore  |           |         |
| 12 | A ofron infermierja këshillim/udhëzime për pacientin/familjarin në përgjigje të situatës shëndetësore që paraqet pacienti në ditën e vizitës?                            |           |         |
| 13 | A është adresuar nevoja për kujdes social në familjen që vizitoni (nëse ka)?   |           |         |

## REFERENCA

1. Training for mid-level managers (MLM). Module 4: supportive supervision. Geneva: World Health Organization; 2008, republished 2020 under the licence: Ç BY-NC-SA 3.0 IGO).
2. Marquez, L.R., & Kean, L.C. (2002). Making supervision supportive and sustainable: new approaches to old problems.
3. Supervising health care services: improving the performance of people Kama Garrison Nancy Caiola Rick Sullivan Pamela Lynam, 2004, ISBN 0-929817-76-1
4. Miratimi i modeleve të Kujdesit Shëndetësor në banesë në Kujdes Shëndetësor Parësor nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. Prot 188, datë 14.10.2021
5. Urdhri “Për Miratimin e udhëzuesit “Supervizimi mbështetës në kujdesin shëndetësor parësor”; Ministria e Shëndetësisë Nr. 497; datë 22.09.2008
6. Udhëzim “Mbi supervizimin tematik të Qendrave Shëndetësore”, Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor, Drejtoria Rajonale Tiranë, Drejtoria e Shërbimit Parësor, Nr.01, Datë 25.08.2022
7. VKM Nr 405, 20-05.2020 Strategjia e Zhvillimit të Kujdesit Shëndetësor Parësor 2020-2025, “Përmirësimi i funksioneve të monitorimit dhe mbikqyrjes mbështetëse të autoriteteve lokale shëndetësore për të siguruar përmirësim të vazhdueshëm të cilësisë; Të organizohen shërbimet e KSHP-së, të integruara gjithnjë e më shumë me kujdesin social në nivel lokal, duke përfshirë kujdesin në banesë”; **Politika 7**-Përcaktimi dhe pilotimi i tipeve të reja të shërbimeve dhe rishpërndarja gjeografike
8. **VKM Nr. 101, datë 4.2.2015 PËR MIRATIMIN E PAKETËS SË SHËRBIMEVE SHËNDETËSORE, NË KUJDESIN SHËNDETËSOR PARËSOR PUBLIK, QË FINANCOHET NGA FONDI I SIGURIMIT TË DETYRUESHËM TË KUJDESIT SHËNDETËSOR**

## SHKURTIME

KSHB - Kujdesi Shëndetësor në Banesë

KSHP - Kujdesi Shëndetësor Parësor

QSH - Qendër Shëndetësore

FSDKSH - Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor

NjVKSH - Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor NJVNR- Njësia e

vlerësimit të nevojave dhe referimit